



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:260478

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06525337

2023:260479

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL, gjyqtarja Kreshnike Zymberi Beqiri me bashkëpunëtoren profesionale Ilirjana Hashani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve A. I.B. B. dhe E. D. të gjithë me vendbanim në Komunën e të cilët i përfaqëson me autorizim av. Labinot Buzuku nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurës Komuna Shtimes - Drejtoria e Arsimit, në çështjen juridike kompensim i të ardhurave në emër të inflacionit, shujtës dhe kualifikimit, vlera e kontestit 4,013.28 euro, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 29 nëntor 2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve : A.I., B. B. dhe E. D., ashtu që DETYROHET e paditura Komuna - Drejtoria e Arsimit, që paditësve:

1. Paditësit A. I. të i kompensojë dhe atë:

a)-në emër të kompensimit për shujte të papaguar për 315 ditë pune (nga data 01.12.2020 - 31.07.2022) të ia paguaj shumë prej 630.00 € (gjashtëqind e tridhjetë euro;

b)- në emër të rritjes së shkallës së inflacionit si pagesë shtesë në pagë, për periudhën kohore për muajt për muajt janar– Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumë prej 108.12 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumë prej 338.14€, në shumë të përgjithshme prej 446.26 € (katërqind e dyzetë e gjashtë euro e njëzetë e gjashtë cent),

2. paditësit B.B. të i kompensojë dhe atë:

a)-në emër të kompensimit për shujte të papaguar për 20 ditë pune (nga data 01.12.2020 - 31.12.2020) të ia paguaj shumë prej 40.00 €;

b)- në emër të rritjes së shkallës së inflacionit si pagesë shtesë në pagë, për periudhën kohore për muajt për muajt janar– Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 537.20 €, në shumë të përgjithshme prej 708.96 € (shtatëqind e tetë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent);

c)-në emër të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit me ngritje page 27% pagës bazë shumen mujore prej 55.35 euro ,nga data 01.12.2020 deri më datë 31.01.2023 për 26 muaj të ia paguaj shumën prej 1,439.10 euro (njëmijë e katërqind e tridhjetë e nëntë euro e dhjetë cent)

3. E.D. dhe atë:

a)-në emër të kompensimit për shujte të papaguar për 20 ditë pune (nga data 01.12.2020 - 31.12.2020) të ia paguaj shumë prej 40.00 € (dyzetë euro);

b)- në emër të rritjes së shkallës së inflacionit si pagesë shtesë në pagë, për periudhën kohore për muajt për muajt janar– Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 537.20 €, në shumë të përgjithshme prej 708.96 € (shtatëqind e tetë euro e nëntëdhjetë e gjashtë cent);

Secili paditës veç e veç të ua paguaj me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguajë shumën prej 248.00 €, në afatin prej 7 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë me datë 29.11.2023, përmes të autorizuarit të tyre Labinot Buzuku kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e– DKA, për kompensimin e shpenzimeve në emër të shujtave , inflacionit dhe diferencës në kualifikim në pagë, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura.

Përfaqësuesi i paditësve në nëntor të vitit 2024 pranë kësaj gjykate ka dorëzuar parashtrësën për precizimin me të cilën ka kërkuar që mbi bazën ligjore të kontratës kolektive e cila ka qene në fuqi e që të punësuarve iu takon kompensimi për kualifikim, inflacion dhe shujta sipas kerkesave per secilin veq e veq ashtu si ne precizim : dhe atë: A. I. në emër të kompensimit për shujte të papaguar për 315 ditë pune (nga data 01.12.2020 -31.07.2022) të ia paguaj shumë prej 630.00 €, në emër të rritjes së shkallës së inflacionit si pagesë shtesë në pagë, për periudhën kohore për muajit për muajt janar– Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 108.12 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 338.14€, në shumë të përgjithëshme prej 446.26 €, e qe vlera e pergjitheshme e kompensimit eshte 1,076.26 euro, paditesit B. B. dhe atë: në emër të kompensimit për shujte të papaguar për 20 ditë pune (nga data 01.12.2020 -31.12.2020) të ia paguaj shumë prej 40.00 €, në emër të rritjes së shkallës së inflacionit si pagesë shtesë në pagë, për periudhën kohore për muajit për muajt janar– Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 537.20 €, në shumë të përgjithëshme prej 708.96 €, në emër të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit me ngritje page 27% pagës bazë shumen mujore prej 55.35 euro ,nga data 01.12.2020 deri më datë 31.01.2023 për 26 muaj të ia paguaj shumën prej 1,439.10 euro; apo e qe vlera e pergjitheshme e kompensimit eshte 2,188.06 euro. Paditesit E. D. dhe atë: në emër të kompensimit për shujte të papaguar për 20 ditë pune (nga data 01.12.2020 -31.12.2020) të ia paguaj shumë prej 40.00 €; në emër të rritjes së shkallës së inflacionit si pagesë shtesë në pagë, për periudhën kohore për muajit për muajt janar– Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 537.20 €, në shumë të përgjithëshme prej 708.96 €, e qe vlera e pergjitheshme e kompensimit eshte 748.96 euro.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëse është e pabazuar pasi që kontrata kolektive e nënshkruar më dt. 17.04.2017 nuk është më në fuqi ndërsa sipas ligjit të punës kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar. Kontrata kolektive ka paraparë që shkalla e inflacionit sipas entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e saj të futet në pagë dhe kompetente për llogaritjen dhe përfshirjen e inflacionit në page është enti i Statistikave të Kosovës. I ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëseve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shumat e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë të kontratave të punës , vertetimeve per ditet e pranise ne pune si dhe lista e pagave për mësimdhënës.

Gjykata përmes kontrates së punës për mësimdhënës me numër të protokollit 05/386-20 e datës 01.09.2021 ka vërtetuar faktin se paditësi B. B. është në marrëdhënie pune në SHFMU “.....” në fshatinKomuna ... dhe ne SHFMU,,.....” ne, nga vërtetimi i lëshuar nga drejtoria e shkollës është vërtetuar faktin se paditësi ka qenë prezentë në punë 20 ditë pune për periudhën 01.09.2020 deri në periudhën 31.12.2020 „per paditesin A.I. nga vërtetimi i lëshuar nga drejtoria e shkollës është vërtetuar faktin se paditësi ka qenë prezentë në punë 315 ditë pune për periudhën 01.12.2020 deri në periudhën 31.07.2022,ndersa per paditesin e trete nga vërtetimi i lëshuar nga drejtoria e shkollës është vërtetuar faktin se paditësi ka qenë prezentë në punë 20 ditë pune për periudhën 01.09.2020 deri në periudhën 31.12.2020,dhe per te njejtit ditët e punës të vërtetuara nga vet punëdhënësi, gjykata i ka shumëzuar me shumë prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së - është paraparë se *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*

Kontratën e punës për mësimdhënës dhe vërtetimet e lartëcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 respektivisht me nenin 48 të këtyre kontratave është përcaktuar se këto kontrata hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditëset e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë dhe të njëjtat përfitojnë nga kjo e drejtë, për faktin se me Kontratën Kolektive të datës 18.04.2017 respektivisht atë të datës 22.01.2021, në nenin 35.10 thuhet *“Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, ku gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës respektivisht listave të pagave ka gjetur se shkalla e inflacionit sipas viteve përkatëse nuk rezulton të jetë futu në pagë si pagesë shtesë, e që rrjedhimisht nënkupton se ka lindur detyrimi i të paditurës për të kompensuar këtë diferencë në pagë sipas viteve përkatëse.

Gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me shkallën e inflacionit e ka bazuar në të dhëna zyrtare të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës përmes faqes zyrtare dhe atë bazuar në këto të dhëna rezulton se, mesatarja vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, për vitin 2019 ka qenë në shkallë prej 2,7%, për vitin 2020 ka qenë në shkallë prej 0,2%, për vitin 2021 ka qenë në shkallë prej 3,4% ndërsa për vitin 2022 ka qenë në shkallë prej 11,6%.

Më tutje, bazuar në këtë mesatare të shkallës së inflacionit, gjykata ua ka njohur paditësive të drejtën në kompensim në emër të inflacionit dhe atë për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% , dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e

inflacionit prej 11.6% të u kompensojë diferencën e papaguar në pagë duke u llogaritur këtë shkallë të inflacionit në pagën bazë prej 421.00 €, andaj bazuar në këtë gjykata ka aprovuar shumat si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkeses lidhur me të drejtën e kompensimit në emër të kualifikimit, gjykata ka gjetur se rastin konkret zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Më tutje kjo e drejtë e paditëses është fuqizuar edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratave të punës ka rezultuar se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ua ka paguar shumën prej 58.32 euro, ku me ç’rast ka pasur për detyrim të i paguaj shumën prej 113.67€ apo në lartësi prej 27% të pagës bazë, andaj bazur në këtë e paditura paditëseve u ka mbetur borxh për çdo muaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur te vlerës për sa do ti takonte kompensimi prej 27% apo në shume prej 113.67€, e që i bije se për 26 muaj nga data 01.01.2020 deri më datë 31.01.2023 i ka mbetur borxh në shumë të përgjithshme prej 1,439.10 €.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritator, pasi që kërkesëpapia e paditësit është brenda periudhës kur kontrata kolektive e arsimit ka qenë në fuqi dhe ka prodhuar detyrime për palët nënshkruese.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e paraqitjes së padisë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 208 euro për përpilimin e padisë si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 40 euro, gjithsej shumën prej 248.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr. 2023:260479, me datë 29 nëntor 2024 12.11.2024

Gjyqtarja

Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.